



Lënda: Oponence. Projekt-Ligj Për Ndryshime Ligji Prokurim Publik
Përgatiti: Organizata AIS / Open Data Përfaqësuar nga Drejtore A. Brahaj
Drejtuar: Parlamentit. Komisioneve që Shqyrtojnë Draft Ligjin.

Data: 5 Shkurt 2024

Organizata AIS / Open Data Albania ka marrë pjesë më herët në konsultimin publik me Qeverinë Shqiptare për Draft Ligjin “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.162/2020, “PËR PROKURIMIN PUBLIK”.

Duke qenë se këtë Javë (e hëna data 5 Shkurt e vijim) ky Ligj tashmë me formulim të ri, po shqyrtohet në Komisionin e Ekonomisë, në Komisionin e Çështjeve Ligjore, Komisionin e Çështjeve të Integritimit, po gjejmë me vend të sjellim në Vëmendje të Kuvendit dhe të kërkojmë rregullime përpara Kalimit në Seancë për disa aspekte si vijon:

Problematika nr. 1 Neni 48/2 bie në Kundërshtim me MSA konkretisht me nenin 74.

Formulimi i kësaj pike është formulimi klasik i një dispozite që është në kundërshtim me parimet dhe përcaktimet që bën analiza “*corruption proofing of legislation*”.

“Neni 48

Dispozita kalimtare

1.

2. Brenda një periudhë 3-vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave mund të autorizojë institucionet e administratës shtetërore/publike në nivel qendror të negociojnë dhe të lidhin marrëveshje konsulence ndërkombëtare brenda fushës së kompetencës së tyre në fusha me interes strategjik, në drejtim të aplikimit të inteligjencës artificiale, sigurisë kibernetike, infrastrukturës kritike dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.”

3..... “

Shqetësimi ynë është se ky nen kalimtar, mund të zbatohet për përdorimin e kontratave të negociuara në mënyrë arbitrare. Ky nen në projektligj u jep mundësi Autoriteteve Kontraktore të shmangen arsyetimit pse zbatojnë procedurat e negociuara. E gjithë kjo nën maskën e mbulesës së "interesit strategjik", nocion i vështirë për t'u përcaktuar (ligji nuk e adreson me qartësi).

Ekzistenca e pikës 2 të nenit 48 të projektligjit zhvlerëson të gjithë përcaktimet pozitive të bëra në ndryshimet e ligjit “Për prokurimin publik”.

Nuk ka asnje arsye logjike dhe legjitime qe te qëndrojë ky formulim. Nëse në të ardhmen lind nevoja për shërbime të konsulencës - në cilëndo prej fushave qe përmend pika 2 e këtij neni - legjislati shqiptar i jep përgjigje ndërmjet:

a) ligjit “Për prokurimin publik”; dhe/ose

b) ligji nr. 36/2020 "Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë"

Ne çdo situatë dhe rrethanë qe gjenden autoritetet qendrore ka përcaktime ligjore shume me te detajuara dhe procedurialisht te sakta ne raport me përcaktimet që bën pika 2 e nenit 48.

Ky formulim i jep me ligj incentivë korrupsionit në fushat e prokurimit, si dhe është në kundërshtim flagrant me të gjithë dispozitat pararendës te ligjit “Për prokurimin publik”.

Oponence: Ne e shohim këtë si jo në përputhje me direktivën, dhe jo në përputhje me frymën e nenit 74 të MSA-së. Ligji ka rrisht potencial për tu aplikuar si Ligj Korruptiv

Rekomandim: Pika 2 e nenit 48 të ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin “Për prokurimin publik” duhet të hiqet nga Projekt-Ligji.

Problematika nr. 2. Relacioni nuk ka asnjë Informacion mbi Kostot Financiare.

Ky Draft Ligj parashikon punë publike për Krijimin e një Sistemi Elektronik të Integruar dhe aplikimin e Inovacionit. Në Relacion nuk është parashikuar asnjë kosto financiare për këtë sistem dhe për ndërhyrjet e parashikuara përmes Projekt Ligjit. Po njësoj Lista e Projekteve Investimeve Publike, Plani Buxhetor Afatmesëm nuk ka një parashikim të tillë.

Konkluzion. Ligji nuk mund të kalojë pa u shoqëruar me përllogaritje të qarta nga Këshilli i Ministrave të Kostove Financiare.

Rekomandim. Parlamenti duhet te kthejë pranë KM Relacionin Shoqëruar të Draft Ligjit për të plotësuar me Kosto Financiare sipas pikës 20 të VKM 584 datë 28.03.2003. Pika 20 e Vendimit te Këshillit te Ministrave nr 584 date 28.03.2003 “Për miratimin e rregullores se këshillit te ministrave” liston si pjese te relacionit shoqëruar raportin e vlerësimit te te ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore te paktën për tre vitet e zbatimit te aktit.

Sa më lart

Ky Ligj nuk duhet të kalojë në Seancën Plenare të datës 8 Shkurt, pa u shoqëruar me Relacion të Detajuar nga KM për Kostot Financiare dhe pa shqyrtuar me kujdes problematikat si ligj me rrisht korrptiv dhe Ligj qe bie ne Kundërshtim me MSA.

I sugjerohet Kuvendit që përpara shqyrtimit Final në Seancë të inicioje, kërkojë edhe një Takim Konsultues me organizata qe veprojnë si Shoqata Biznesi, Shoqata qe Punojnë në Fushën e Shtetit të Së Drejtës, Integritit European dhe Transparencës.

Me respekt

Aranita BRAHAJ

Drejtoreshë AIS / Open DataAlbania